

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E ENJTE 10 SHKURT 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Është e lehtë të jesh i mirë me fjalë, por e vështirë të jesh i ndershëm dhe i drejtë me fakte. Paqja sociale e një vendi demokratik kërkon disa kushte themelore: të vërtetën, drejtësinë dhe lirinë. Të gjitha këto në historinë e shtetit shqiptar kanë qenë shpesh nën thundër sundimi dhe manipulimi. Për fat të keq, kështu edhe në epokën e tranzicionit nga diktatura në demokraci. Në qoftë se nuk respektohet drejtësia, çfarë janë shtetet? “Veçse banda të mëdha hajdutësh”, na kujton Shën Agustini. Shqiptarët janë dëshmitarë të mëdhenj të fatit të tyre. Ata i kanë parë këto banda t’i grabisin natën, t’i zhgërryejnë ditën, t’u vjedhin pronën, t’u rrëmbejnë votën, t’u shkelmojnë dinjitetin, t’u mbyllin gojën, t’u godasin karrierën, t’i shtrëngojnë në ikje, në shtegtim, në emigracion, t’u shkretojnë atdheun. Ata i kanë parë këta hajdutë të pasurohen me para publike, i kanë parë të bëhen kryetar komunash, bashkish, deputetë, ministra, kryetarë qeverish nga dekada në dekadë. Ata e kanë parë Shqipërinë të bjerë pre e barbarisë urbane. I kanë parë sesi pa brekë i gdhiu dita e zengjinë i zuri darka? Prej 5 vjetësh, me nxitjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian, në vend ka filluar reforma në drejtësi, e cila po ecën ngadalë, nën presion politik të vazhdueshëm, për të qenë të kapur dhe nën kontroll politik, familjar e krahinor. Presionet, tentakulat, kapjet e kanë vonuar procesin dhe rezultatet e tij. Reforma në drejtësi duhet, por nuk po arrin të sjellë në sistem gjykatës të rinj, mundësisht studentë, të cilët kanë ardhur nga jashtë shtetit, ku kanë studiuar këta 20 vjet, por ajo po bën një përzierje të gjykatësve të vjetër të komunizmit me produktet më të dobëta të shkollave shqiptare.

Me një fjalë, nëse ka diçka që e rrezikon drejtësinë pas korrupsionit është injoranca, çka kjo reformë nuk po e zgjidh. Vetingu sot ka objekt materien, sa makina, sa para, sa vila, sa prona, tepria e të cilave është abuzim dhe duhet goditur. Vetingu nuk po e ndihmon drejtësinë të fitojë aftësinë. Në fund të fundit, çfarë vlere ka një gjyqtar i varfër dhe injorant? Ky tip punëtori i drejtësisë është më i dëmshëm sesa një i korruptuar dhe i aftë profesionalisht, por të dy bashkë e vrasin drejtësinë. Partia Demokratike nuk e ka penguar reformën në drejtësi, ajo nuk e pengon vetingun, por ajo denoncon të gjitha përpjekjet, që ky veting, kjo reformë t’i shërbejë vetëm një njeriu, që t’i shërbejë vetëm një tarafi, që t’i shërbejë fasadës demokratike të vendit. Ne s’kemi asgjë për të fshehur, asgjë për të pasur frikë dhe e votojmë shtyrjen e vetingut, me kërkesën permanente që faktori ndërkombëtar, OMN-ja, i vetmi garant, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian, të shtojnë presionin pozitiv për ta nxjerrë procesin nga ahengu i familjaritetit të qeverisë, nga kushërinjtë, tezet dhe hallat, ta nxjerrë atë nga diferenca krahinore e religjioze, ta nxjerrë nga diskriminimi i pilotuar. Do të jetë një luftë e vështirë, do të jetë një mundim i madh, sepse kjo mazhorancë, kushërirë e parë e komunizmit dhe vetvetja, nënë e abuzimeve, nuk kërkon drejtësi, por iluzionin e saj. Opozita është këtu.

Ajo ka në dorë një qiri drite, të cilët i frynë bulçi si turbina korrupsioni, nga të gjitha anët, për ta fikur, por nuk do të ndodhë kështu. Sot flitet shumë për ish-ministrat, të cilët dënohen pas disa vitesh që kanë lënë detyrën, pasi u jepet mundësia që të zvogëlojnë sadopak koston politike të qeverisë, tolerohen. U jepet mundësia të krijojnë distancë, por nuk mjafton aspak. Gjithsesi, kjo është më mirë

sesa hiç. Drejtësia duhet të shohë pushtetin, inceneratorët, kryeministrin, ministrat, pushtetin lokal, tenderat, rrugët, aktualitetin, që të fitojë besimin e gjymtuar, sepse servilizmin dhe nënshtrimin s'ka ende instrumente për t'i hetuar, por kjo është çështje etike. Pastaj, le t'i turret së shkuarës, se nëse ajo harrohet, bëhet mësuese e keqe e jetës. Këtë nyje gordiane, me duart që dridhen, nuk po e pret shpata e drejtësisë sonë. Jemi në zgjedhjet e pjesshme lokale dhe ende pas 6 vjetësh nuk kemi dritë, nuk kemi hetime për dosjet e Dibrës dhe të Shijakut. Askush nuk është hetuar, askush nuk është dënuar. Zgjedhjet janë përsëri në rrezik nga të njëjtët hajdutë. Kur një menu restoranti kushton 500 mijë dollarë, ende drejtësia vlerën e saj morale e ka 5 lekë. Pikëpyetjet janë të shumta, zhgënjimet edhe më të shumta, nga reforma dhe rezultatet e saj. Njëkohësisht qytetarët kanë rastin të shohin kush e pengon integrimin, i cili sot është i rrezuar përtokë, dhe kush e nxit atë. Nëse dyert mbyllen, përsëri prej korrupsionit dhe arrogancës së qeverisë, për mungesën e standardeve demokratike, gishtit të drejtuar tek opozita duhet t'i gjejnë vend për ta drejtuar diku tjetër. Pak më parë mbajtëm një minutë heshtje për Eduard Kukanin, por nuk u tha një gjë themelore, nuk u tha që ishte njëri nga mbështetësit kryesorë të ligjit për dekriminalizimin, i cili ndihmoi për të nxjerrë, të paktën, horrat dhe kriminelët e dukshëm nga kjo sallë. Faleminderit!